



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
OSNOVNI SUD DJAKOVICA – BASIC COURT OF GJAKOVË

AD/GJTHGJA.nr. 04/24

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – kryetari i gjykatës Nikollë Komani, duke vendosur përkitazi me ankesën disiplinore të parashtruar nga ankuesi B. Th. nga fshati H. Komuna Gjakovës, ndaj gjyqtarës M. Sh., pas shikimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të ankesës, me datë 11 nëntor 2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet ankesa disiplinore e parashtruar nga ankuesi B. Th., ndaj gjyqtarës M. Sh., si e pabazuar.

A r s y e t i m

Me datën 04 nëntor 2024 ankuesi B. Th., në adresën zyrtare elektronike “gjthgjakove@gjyqesori-rks.org”, ka dorëzuar ankesën ndaj gjyqtarës M. Sh., lidhur me lëndë C.nr.821/20.

Pas pranimit të kësaj ankese dhe pas analizimit të përmbajtjes së saj, e njëjta është regjistruar në librin e ankesave disiplinore me numër AD/GJTHGJA.nr.04/24 me datën 04 nëntor 2024 dhe janë ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore që janë në kompetencë të kryetarit të Gjykatës, sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë.

Me shkresën AD/GJTHGJA.nr.04/2024 të datës 05 nëntor 2024, përmes email-it zyrtar është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës, për veprimet e ndërmarra lidhur me ankesën e parashtruar nga ana e ankuesit.

Ankuesi B. Th., në ankesën e tij të dorëzuar me datë 04 nëntor 2024 ka theksuar se *“Me datë 09.11.2020 ka bërë padi për shkurorëzim, por kjo lëndë më është stërzgatur me vite. Ka theksuar se autorizimin e parë ja ka dërguar avokatit Y. B., por pas një kohe avokati e ka rekomanduar që lëndën ta kaloj te avokatja E. S., me arsyetimin se kjo e ka mirë me gjyqtaren e çështjes dhe bënë një zgjidhje të shpejtë dhe lënda ka kaluar me marrëveshje gojore te avokatja E. S., e cila me datë 24.10.2023 e ka revokuar në tërësi autorizimin duke më kërkuar dyfishin e shumës që jemi marr vesh për pagesë, ku i ka lajmëruar të gjithë avokatët se ky person nuk ma ka paguar (nuk ka qenë*

e vërtetë arsyetimi sepse çdo bisedë ka qenë me shkrim, por unë mendoj se është paguar nga pala kundërshtare për tërheqje dhe me e marr dyfishin e shumës që jemi marr vesh)”. Më tutje në parashtrësën e tij ka shtuar se “Me datë 30.11.2023, ish bashkëshortja ka bërë padi në Gjermani, ku gjykata gjermane më ka kërkuar një vërtetim nga gjykata që është aktive, kopjen e padisë dhe fletë kthesën nga posta. Vërtetimin dhe kopjen e padisë e kam marr nga Gjykata e Gjakovës, por fletë kthesën nuk ma kanë dërguar, e kam përkthyer nga gjermanishtja në shqip dhe e kam dërguar në Gjykatën e Gjakovës për të kuptuar se çka po kërkojnë, por pa sukses. Më është dashur 10 muaj që të pres deri sa unë kam shkruar në email zyrtar të gjykatës për të ma dërguar fletë kthesën, për këtë ju falënderoj shumë për korrektësinë. Me datë 26.08.2024 kam bërë një takim me gjyqtaren M. Sh., që te ja shpjegoj se çfarë duan gjykata në Gjermani dhe përgjigja ka qenë “në rregull ta bëjë gati për dy ditë”, por nuk ma ka dërguar fletë kthesën siç biseduam gojarisht, por prapë diçka tjetër dhe lind dyshimi se përse gjyqtarja nuk po ma jep fletë kthesën, dhe pse brenda një jave u tërhoq avokatja E. S., çfarë lidhje ka me gjyqtaren. Unë kam kërkuar nga avokati im N. M., që të flas gojarisht edhe njëherë me gjyqtaren se vetëm fletë kthesa po më nevojitet dhe avokati e ka taktuar gjyqtaren me datë 18.10.2024 në gjykatë dhe i ka kërkuar edhe njëherë fletë kthesën gojarisht, por prapë pa sukses, edhe pse ja ka dërguar disa parashtrësia edhe ato pa sukses. Pas këtij dështimi unë kam qenë i detyruar që të gjej një zgjidhje tjetër dhe ju kam shkruar në faqen zyrtare”, ndër të tjera ka shtuar se “kam dyshimet e mijta në E. S. dhe gjyqtaren M. Sh., pasi më janë dashur 10 muaj për një fletë kthesë, deri sa ju kam shënuar në email-in zyrtar të gjykatës”. Andaj, ka kërkuar që ankesa të merret parasysh në bazë të kompetencave që kemi.

Gjyqtarja M. Sh., në deklaratën e saj të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e ankuesit ndër të tjera ka theksuar se: “Kjo lëndë është pranuar në zyrën time pas përfundimit të trajnimit në Akademinë e Drejtësisë, gjegjësisht më datë 17.03.2022, pra shikuar kohën kur avokatja E. S. e ka dorëzuar autorizimin për përfaqësim ka qenë data 03.11.2021, para se unë si gjyqtare të jem ngarkuar me çështjen në fjalë”. Sa i përket takimit në mes të paditësit dhe gjyqtarës së çështjes, ka njoftuar se “I njëjti ka qenë në zyre, mirëpo nga ana e ime është njoftuar që për çdo kërkesë t’i drejtohet gjykatës me shkrim, për çka i njëjti me datë 29.08.2024 ka bërë kërkesë lidhur me kërkimin dokumenteve të lartcekura”. Ndër të tjera ka theksuar se pas kërkesës së bërë nga paditësi, përmes zyrës së kryetarit të gjykatës, i janë dërguar dy shkresa që kanë qenë në gjuhen gjermane të fotokopjuara. “Në këtë çështje padia fillimisht është iniciuar nga paditësi përmes avokatit Y. B., i cili me 04.10.2021 ka denoncuar autorizimin dhe me datë 03.11.2021 paditësi ka autorizuar avokatin E. S. për ta përfaqësuar në këtë çështje. Në ndërkohë çështja i është dërguar për përgjigje të paditurës M. Th. përmes bashkëpunimit juridik ndërkombëtar dhe më datë 02.01.2023, e paditura ka autorizuar avokatin M. B. dhe pas kësaj gjykata ka vazhduar komunikimin me të njëjtën, ku me datë 26.04.2023 ka bërë përgjigjen në padi. Me datë 24.10.2023, avokatja E. S. përmes një parashtrëse ka denoncuar autorizimin, që realisht paditësi ka mbetur pa përfaqësues në këtë çështje kontestimore, ku paditësi ka autorizuar babin e tij Sh. Th. i cili me datë 07.03.2024, i është drejtuar gjykatës se në shtetin e Gjermanisë është iniciuar procedura lidhur me këtë çështje, në mes të palëve të njëjta dhe ka kërkuar nga gjykata që të siguroj dëshmi mbi paraqitjen e padisë në Gjykatën Themelore të Gjakovës, si dhe është pranuar nga e paditura kjo padi. Gjykata me shkresën 19.03.2024, i ka dorëzuar të bashkangjitura këto dëshmi, e pranuar nga e autorizuarja e të paditurës dhe faktin se përgjigjen në padi e ka ushtruar e autorizuarja e të paditurës. Me datë 18.04.2024, paditësi ka autorizuar avokatin N. M., i cili me shkresën e të njëjtës datë ka kërkuar nga gjykata shkresat duke shënuar tekstualisht “ju lutemi që sa më shpejtë të jetë e mundur të ma dërgon përgjigjen në padi të ushtruar nga ana e palës së paditur dhe njëherë

përgjigjes të ja bashkëngjitni edhe fletë kthesën që i autorizuari i palës së paditur e ka pranuar në mënyrë të rregullt, pasi që e njëjta na duhet për ta dërguar në Gjermani”. Po i njëjti avokat është paraqitur edhe personalisht në zyrën e gjyqtarës dhe ku të njëjtit i është kërkuar që për çdo kërkesë të procedohet me parashtrësë, ashtu siç e parasheh ligji. Ndër të tjera ka shtuar se “Lidhur me dërgimin e shkresave nga ana e gjykatës, përkatësisht nga unë si gjyqtare, për mua ka qenë e dhënë që duhet të dërgohet fletë kthesa me të cilën e autorizuar e të paditurës e ka pranuar padinë dhe e njëjta ka parashtruar përgjigje dhe meqenëse e paditura ka pasur të autorizuar në Kosovë, atëherë komunikimi është vazhduar çdo herë me të paditurën, për çka edhe i kam proceduar fletë kthesat me të cilën e autorizuar e të paditurës ka pranuar padinë së bashku me prova”.

Kryetari i Gjykatës, pas vlerësimit dhe analizimit të ankesës së ankuesit, deklaratës së gjyqtarës, si dhe shkresave të lëndës C.nr. 821/2020, gjeti se **ankesa është e pabazuar**.

Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e ankuesit se ish avokati tij Y. B., e ka rekomanduar që lëndën ta kalojnë te avokatja E. S. me arsyetimin se kjo e ka mirë me gjyqtaren e çështjes dhe se e njëjta do të bëjë në zgjidhje të shpejtë dhe ka konstatuar se ky pretendim i ankuesit është vetëm deklarativ, i pabazuar me asnjë provë apo dëshmi të vetme, si dhe është në kundërshtim me shkresat-provat e kësaj lënde. Se ky pretendim i ankuesit është i pabazuar dhe në kundërshtim me shkresat e lëndës argumentohet nga fakti se gjyqtarja M. Sh., ndaj secilës është paraqitur ankesa me këtë lëndë është ngarkuar në muajin mars të vitit 2022, ndërsa avokatja E. S. autorizimin e ka dorëzuar në Gjykatë me datë 03.11.2021. Pra avokatja E. S. është autorizuar në kohën kur me këtë lëndë ka qenë i ngarkuar një gjyqtar tjetër, e jo gjyqtarja M. Sh., ashtu siç pretendon ankuesi.

Po ashtu, janë vlerësuar dhe analizuar pretendimet e ankuesit se i janë dashur dhjetë muaj për të ia dërguar fletë kthesën të cilën ia ka kërkuar gjykata në Gjermani dhe bazuar në shkresat e lëndës kryetari i Gjykatës ka konstatuar se lidhur me këtë kërkesë nga ana zyrës së gjyqtarës dhe administratës, ankuesit dhe të autorizuarve të tij i janë dhënë disa përgjigje. Mirëpo, bazuar në shkresat e komunikimit që ka pasur ankuesi dhe përfaqësuesit e tij me administratën e gjykatës është konstatuar se ka pasur keqkuptim se cilën shkresë saktësisht e kërkon ankuesi, e këtë fakt e argumenton edhe kërkesa e vetë avokatit N. M., i cili përfaqëson palën paditëse-ankuesin, i cili në parashtrësën e datës 18.04.2024, ka parashtruar këtë kërkesë dhe me këtë përmbajtje “*Ju lutemi që sa më shpejtë të jetë e mundur të ma dërgon përgjigjen në padi të ushtruar nga ana e palës së paditur dhe njëherë përgjigjes të ja bashkëngjitni edhe fletë kthesën që i autorizuari i palës së paditur e ka pranuar në mënyrë të rregullt, pasi që e njëjta na duhet për ta dërguar në Gjermani sepse Gjykata kompetente e ka kërkuar fletë kthesën se a e ka marr padinë pala paditëse në mënyrë të rregullt*”. Bazuar në këtë kërkesë dhe pasi që pala e paditura e ka autorizuar avokaten M. B., e cila me datë 26.04.2023 ka bërë përgjigje në padi, zyra e gjyqtarës, përfaqësuesit të autorizuar të paditësit-ankuesit, avokatit N. M. ja kanë dorëzuar fletë kthesën e komunikimit me avokaten M. B. si përfaqësuese e palës së paditur ashtu siç ai ka kërkuar me këtë kërkesë.

Fakti se ankuesit i është dhënë përgjigje nga administrata e gjykatës argumentohet jo vetëm nga deklarimi i vetë ankuesit i cili ka theksuar se ka pranuar shkresat, por jo atë që ka kërkuar fletë

kthesën, argumentohet edhe nga komunikimi i tij me gjykatën përmes emali-it zyrtar dhe përgjigjet të cilat i janë dhënë të njëjtit përmes komunikimit elektronik deri sa saktësisht ka qenë e qartë se cila është kërkesa e ankuesit, e të cilit i është ofruar edhe mundësia që qoftë vetë apo përmes përfaqësuesit të autorizuar të vije në Gjykatë e të shikoj shkresat e lëndës, apo të i fotokopjohet lënda në tërësi, pasi që përmes ankesave nuk është arritur të kuptohet se cilat shkresa saktësisht i kërkon.

Andaj, mbi këto baza dhe argumente vërtetohet se në veprimet e gjyqtarës nuk janë konstatuar shkelje të ligjit, të cilat do të konsideroheshin shkelje disiplinore, për këtë arsye kryetari i Gjykatës gjeti se pretendimet ankimore janë të pabazuara, pasi nga të lartcekurat nuk rezulton se veprimet e ndërmarra nga gjyqtarja M. Sh., përbëjnë bazë për inicimin e procedurës disiplinore në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Nga arsyet e theksuara më lartë, si dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 9 par. 6 të Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nenit 7 par. 3 pika 3.2 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
AD/GJTHGJA.nr. 04/24, datë 11 nëntor 2024

Kryetari i Gjykatës

Nikollë Komani

Vendimi i dorëzohet:

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Parashtruesit të ankesës*
- 3. Gjyqtarës*